REPUBLIKA E KOSOVËS
Republika Kosova – Republic of Kosovo

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT / TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKI
Nr/Br. 347/19
Datum. 01.08.19
PRISHTINË - PRIŠTINA

PSH. nr. 347 / 19

PANELI SHQYRTUES, i emëruar nga Kryetari i OSHP-së, në bazë të nenit 105 dhe nenit 106 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, në përbërje z. Blerim Dina - Kryetar, z. Nuhi Paçarizi - Referues, z. Goran Milenković – Anëtar, si dhe duke u bazuar në nenin 30 të Rregullores së Punës së OSHP-së nr. 01/2017 të dt: 20.03.2017, pas shqyrtimit të kërkesës së datës 26 Korrik 2019, të parashtruar nga OE "Eskavatori"shpk për tërheqje të ankesës së dt: 27.06.2019 lidhur me aktivitetin e prokurimit "Furnizim me Asfalt" me nr. të Prokurimit: 019-020-121 të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues - "Ndërmarrja Publike Banesore"SH.A me datën 01.08.2019, mori këtë:

V E N D I M

I.APROVOHET, kërkesa e datës 26 Korrik 2019, e operatorit ekonomik "Eskavatori"shpk për tërheqjen e ankesës me nr. 347 / 19, të datës 27.06.2019, lidhur me aktivitetin e prokurimit "Furnizim me Asfalt" me nr. të Prokurimit: 019-020-121 të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues "Ndërmarrja Publike Banesore"SH.A

II.NDËRPREHET, procedura e shqyrtimit të ankesës së operatorit ekonomik "Eskavatori" shpk me nr. 347 /19 të datës 27.06.2019, lidhur me aktivitetin e prokurimit "Furnizim me Asfalt" me nr. të Prokurimit: 019-020-121 e iniciuar nga Autoriteti Kontraktues "Ndërmarrja Publike Banesore"SH.A.

III.I LEJOHET, autoritetit kontraktues, që të vazhdoj më tutje me këtë aktivitet të prokurimit përkitazi me këtë ankesë, ndërsa nëse ka ankesë tjetër, ajo vazhdon të shqyrtohet në mënyrë të rregullt dhe aktiviteti i prokurimit mbetet i pezulluar ashtu siç parashihet në nenin 112 paragrafi 1 të LPP-së.

IV. Meqenëse aprovohet tërheqja e OE ankues nga ankesa dhe pretendimet ankimore, si dhe duke u

bazuar në nenin 30.2 të Rregullores së punës së OSHP-së, këtij OE i kthehet sigurimi i ankesës në vlerën e deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës.

V. Urdhërohet, OE ankues që konform nenit 33 pika 6 e Rregullores të Punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën i bëhet konfiskimi i depozitës, dhe këto mjete kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

ARSYETIM

Operatori Ekonomik "Eskavatori"shpk ka parashtruar ankesë në OSHP me datën 27.06.2019, me nr. 347 /19, lidhur me aktivitetin e prokurimit "Furnizim me Asfalt" me nr. të Prokurimit: 019-020-121 të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues "Ndërmarrja Publike Banesore"SH.A duke pretenduar se AK-ja, ka bërë shkelje të nenit 7 të Ligjit për Prokurim Publik te Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092,

Me datën 27.06.2019, është njoftuar autoriteti kontraktues nga OSHP-ja për pranimin e ankesës së lartpërmendur lidhur me aktivitetin e "Furnizim me Asfalt" me nr. të Prokurimit: 019-020-121

Organi Shqyrtues i Prokurimit, konform nenit 113 dhe 114 të LPP-së me datë: 06.07.2019 ka autorizuar ekspertin shqyrtues profesional të prokurimit për të shqyrtuar vlefshmërinë e të gjitha pretendimeve të palës ankimore.

Eksperti Shqyrtues profesional në raportin e dt: 15.07.2019, lidhur me pretendimin ankimore te OE ankues: "Eskavatori"shpk në finalizim te analizimit dhe shqyrtimit te këtij aktiviteti te prokurimit, konstaton si në vijim:

Duke u bazuar në dokumentacionin e ofruar dhe rrjedhës faktike të procedurës, Ekspertja shqyrtuese i propozon panelit shqyrtues qe ankesa e lartpërmendur të operatorit ekonomik të ***Hedhë Poshtë si të pa bazuar*** dhe i rekomandon panelin shqyrtues qe të mbetet në fuqi Njoftimi për kontrate dhe dosjen e Tenderit

Përfaqësuesi i OE ankues "Eskavatori"shpk me datën 26.07.2019, ka deponuar në OSHP, kërkesën për tërheqjen e ankesës, lidhur me tenderin me titull "Furnizim me Asfalt" me nr. të Prokurimit: 019-020-121 të zhvilluar nga Autoriteti Kontraktues "Ndërmarrja Publike Banesore" SH.A me arsyetimin se duke pasur parasysh sasitë e vogla qe janë kërkuar ne dosje te tenderit dhe shpenzimet e transportit janë shume te larta dhe gjithashtu me qellim te mos zgjatjes se procedurës, vendosem qe te bëjmë tërheqjen e ankesës se parashtruar në OSHP me datën 27.06.2019. E njëjta është aprovuar nga Paneli Shqyrtues i OSHP-së

Paneli shqyrtues, pasi shqyrtoj kërkesën e operatorit ekonomik ankues, vendosi si në diapozitiv të këtij vendimi.

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet vetem Gjykatës themelore-Departamentit për çështje Administrative për kompensim dëmi ne afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të vendimit .

Kryetar i panelit shqyrtues

z. Blerim Dina

Vendimi t'i dorëzohet:

1x1 AK – "Ndërmarrja Publike Banesore"SH.A

1x1 OE - "Eskavatori"shpk

1x1 Arkivës së OSHP-së;

1x1 Për publikim në web- faqe të OSHP-së.